



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SHPLLJE POZICIONI VAKANT

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës, shpall procedurën e konkurimit për vendin e lirë të punës për pozicionin:

Punonjës Mbështetës në Terren, Drejtorja e Monitorimit dhe Zbatueshmërisë së Lejeve të Ndërtimit (Kategoria klasa IX).

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; VKB Nr.169 datë 24.12.2021 “Për Organizimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë së Tiranës; Urdhër Nr.414, datë 06.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë;

Kërkesat e posaçme për përzgjedhjen e kandidatëve :

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së presë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje ;
- Diplomë ose dëftesë e arsimit të mesëm, *(për diplomat jashtë vendit, të përcillet njëhësi nga MAS)*;
- Të ketë njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Zoterimi i nje gjuhe te huaj përben avantazh;
- Të ketë aftësi të mira drejtuese,menaxhuese, raportuese, komunikimi dhe të punës në grup;

Punonjësi Mbështetës në Terren ka për detyrë si më poshtë:

- Zbaton programin e punës sipas miratimit nga Drejtori i Drejtorisë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- Kontrolli i territorit të Bashkisë Tiranë në lidhje me lejet e ndërtimit;
- Inspektimi i vazhdueshëm i objekteve me leje ndërtimi në të cilin është caktuar nga Drejtori i Drejtorisë dhe Kryeinspektori;
- Trajton ankesat e marra nga insitucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizikë e juridik. Merr masat për zgjidhjen e tyre;
- Trajton ankesat e marra nga insitucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizikë e juridik. Merr masat për zgjidhjen e tyre sipas orientimit nga Drejtori;
- Në funksion të zbatimit të planeve mujore harton planet ditore të punës duke vendosur prioritetet që i miraton tek Drejtori i Drejtorisë.
-

Dokumentat që aplikanti për Punonjës Mbështetës në Terren duhet të paraqesë janë si më poshtë:

1. CV;
2. Kopje ID;
3. Diplomë (ose dëftesë e arsimit të mesëm) dhe listë notash të noterizuara;
4. Çertifikatë personale dhe familjare;
5. Librezë pune origjinale;
6. Raport mjeko – ligjor;
7. Dëshmi penaliteti;
8. 2 fotografi;
9. Çertifikata, kualifikime etj (nëse dispononi);

Dërgimi i dokumentacionit do të bëhet pranë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në adresën : Rr. “Abdi Toptani”, 1001, Tiranë, afati është deri me datë **20.09.2023** ora **16.30**.